

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË SHQIPTARE

TREMUJORI I PARË 2003

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare për tremujorin e parë të vitit 2003 mund t'i përgjithësojmë në: rritje të shkëmbimeve në aktivitetin tregtar, deficit të llogarisë korente, rritje e njëkohëshme e detyrimeve dhe e mjeteve financiare ndaj botës e shoqëruar me rritjen e rezervave të autoritetit monetar

Deficiti korent, në fund të tremujorit, vlerësohet rreth 56 milionë dollarë dhe është shkaktuar kryesisht nga rritja e deficitit tregtar të mallrave. Importet neto të kapitaleve kanë mbuluar tërësisht deficitin korent dhe janë shoqëruar me rritjen e rezervave valutore.

Importi i mallrave llogaritet në 394.1 milionë dollarë, 25 për qind më i lartë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2002. Rritja e importeve ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes më të madhe të kërkesës për investime në raport me atë për konsum. Kjo duket qartë nëse vërejmë kategoritë e importit që kanë shprehur rritjen më të madhe. Konkretisht, importet në makineri e pajisje, mjete transporti, importet në karburante dhe energji elektrike, si dhe në lëndë e parë për industrinë e përpunimit aktiv në vend.

Konsiderueshëm në rritje vlerësohen të ardhurat nga **eksporti i mallrave**, i cili këtë tremujor arriti në kuotën 108.6 milionë dollarë, duke regjistruar një nivel rreth 43 për qind më të lartë krahasuar me periudhën korresponduese në vitin paraardhës.

Rritja në eksporte erdhi në masë të konsiderueshme si rezultat i rritjes së volumit të rieksperteve (eksporte me material porositi), me 42.6 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2002. Gjithashtu në rritje, shfaqet eksporti nga prodhimi i brendshëm (me 43.3 për qind), megjithatë shkalla e kontributit të tij në volumin total të eksporteve mbetet rreth nivelit 22 për qind.

Edhe pse me volume në rritje, ecuria e eksporteve mbetet e dobët duke mos dhënë impakt në vlera absolute në zbutjen e deficitit tregtar të mallrave. Peshën më të madhe në volumin tregtar vazhdojnë ta zënë importet, rreth 78 për qind.

Deficiti tregtar arriti në rreth 286 milionë dollarë dhe vlerësohet 19 për qind më i lartë krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit paraardhës.

Volumi i përgjithshëm tregtar llogaritet në rreth 503 milionë dollarë dhe përfaqëson në masën 50 për qind transaksionet korente të zhvilluara gjatë tremujorit të parë të vitit 2003. Kundrejt tremujorit të parë të vitit 2002 tregtia në mallra vlerësohet në rritje, me 28 për qind. Gjatë këtij tremujori flukset hyrëse dhe dalëse të mallrave vlerësohen në kuotat më të larta të arritura në periudha fillimvitesh.

Aktiviteti tregtar zhvillohet gjerësisht me vendet e Bashkimit Evropian, i cili përfaqësoi tregun kryesor për importe (në masën 72 për qind). Nisur nga fakti që eksportet shqiptare gjerësisht përfaqësohen me rieksperte nga fusha e përpunimit aktiv në vend, me investitorë kryesorë Italinë dhe Greqinë, shkëmbimet tregtare me vendet e Bashkimit Evropian në eksporte ruajnë nivele të larta, rreth 96 për qind. Eksportet shqiptare gëzojnë, gjithashtu, të drejtën e hyrjes *duty-free*¹ në tregun evropian. Megjithatë, mungesa e kapaciteteve të brendshme për eksporte ka bërë që përgjithësisht kjo lehtësi të mos japë efekte të dukshme.

Tregtia e shërbimeve, këtë tremujor, regjistroi një volum të madh transaksionesh prej 246 milionë dollarësh, i cili vlerësohet 18.2 për qind më i lartë se ai i periudhës korresponduese të një viti më parë. Kjo rritje reflektohet si në eksportin ashtu edhe në importin e të gjitha aktiviteteve të shërbimeve, kryesisht në "shërbimet e transportit" dhe në "shërbimet e tjera", ndërkohë që volumi i shërbimeve nga aktiviteti i turizmit ka ruajtur pothuajse të njëjtat nivele me ato të një viti më parë.

Eksporti i shërbimeve (127.5 milionë dollarë) vlerësohet 22.2 për qind më i lartë se tremujori i parë i vitit 2002. Megjithë rënien prej rreth 5 për qind të të ardhurave nga turizmi, i cili zë peshën kryesore në tregtinë e shërbimeve (62 për qind), kjo rritje është mundësuar prej "shërbimeve të transportit"² dhe prej "shërbimeve të tjera" (kryesisht shërbimet e komunikacionit, ato financiare e të tjera).

Vlen të përmendet se eksporti i shërbimeve vlerësohet 17.5 për qind më i lartë se eksporti i mallrave gjë që tregon se për reduktimin e deficitit korent krahas politikave nxitëse për rritjen e eksportit të mallrave, vëmendja duhet të përqëndrohet edhe në nxitjen e eksporteve të shërbimeve.

Importi i shërbimeve (118.5 milionë dollarë) vlerësohet i rritur me 14.1 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2002. Importi i mallrave ka ndikuar në rritjen prej 24 për qind të zërit "shërbime të transportit të mallrave".

Bilanci pozitiv i "**të ardhurave**", në fund të tremujorit të parë të këtij viti, vlerësohet rreth 32 milionë dollarë ose 8 për qind më i lartë se i njëjti tremujor një vit më parë. Kjo rritje i dedikohet të ardhurave më të larta nga puna e punëtorëve sezonalë, e atyre kufitarë si dhe rritjes prej 2.3 herë të interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar, në formën e investimeve të portofolit.

Dërgesat nga emigrantët, për këtë tremujor, vlerësohen rreth 193 milionë dollarë ose rreth 6 për qind më shumë se në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Këto flukse hyrëse kanë

¹ Në shtator të vitit 2002, Komisioni Evropian zgjeroni zonën e lirë tregtare duke iu dhënë të drejtën e hyrjes *duty-free* në tregun e Bashkimit Evropian eksporteve nga vendet Evropës Juglindore. Për Shqipërinë kjo lehtësi tregtare është kryesisht e aplikueshme për produkte industriale.

financuar 67.6 për qind deficitin tregtar. *Një shifër e tillë mund të konsiderohet si një tregues i besueshëm për një parashikim optimist për dërgesat e emigrantëve, të cilat në zhvillime normale duhet të arrijnë një shifër mbi 650 milionë dollarë për të gjithë vitin.* Megjithatë, rritja e dërgesave nga emigrantët është kompensuar pjesërisht nga tkurrja e transfertave korente shtetërore prej 29.3 për qind (kryesisht vihet re rënie në ndihmat në mallra). Për rrjedhim, bilanci pozitiv i transfertave korente vlerësohet vetëm 4.4 për qind më i lartë.

Financimi i deficitit korent është mundësuar nga flukset hyrëse të kapitaleve, të cilat kanë çuar në rritjen e detyrimeve të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës. Transfertat kapitale regjistrojnë 31 milionë dollarë dhe llogaria financiare ka regjistruar një bilanc pozitiv prej 39.7 milionë dollarësh. Ky import kapitalesh është realizuar kryesisht prej thithjes së investimeve të huaja direkte dhe prej lëvrimeve të kredive afatgjata dhe të zbutura nga jashtë, duke shkaktuar rritjen e detyrimeve financiare me 51 milionë dollarë, e cila vlerësohet 57 për qind më e lartë se ajo e periudhës korresponduese të një viti më parë.

Investimet e huaja direkte vlerësohen 27 milionë dollarë. Në masë të konsiderueshme përfaqësohen nga investime në fushën e industrisë së nxjerrjes dhe të përpunimit të mineraleve të lëngshme.

Lëvrimet e kredive nga jashtë (përfshirë edhe përdorimin e huave nga FMN) vlerësohen 23 milionë dollarë nga të cilat 74.7 për qind kanë shkuar në favor të sektorit të qeverisë duke çuar në rritjen e borxhit të jashtëm të këtij sektori. Financuesi kryesor mbetet Banka Botërore nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA).

Pretendimet tona financiare në fund të tremujorit të parë janë rritur vetëm me 11.4 milionë dollarë. Kjo rritje reflektohet kryesisht në mjetet e sistemit tonë bankar në formën e investimeve të portofolit, ndërkohë që depozitat e rezidentëve dhe të sistemit tonë bankar në bankat dhe institucionet financiare jashtë, kanë rënë me 8.7 milionë dollarë.

Rezervat e autoritetit monetar, në tremujorin e parë të këtij viti, u rritën me 57 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet rreth 8 herë më e madhe se ajo e të njëjtit tremujor të një viti më parë.

Arsyet kryesore që qëndrojnë prapa kësaj rritjeje të madhe janë:

- thellimi i mëtejshëm i zhvlerësimit të dollarit amerikan në tremujorin e parë të këtij viti;
- ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet blerjes së valutës së huaj në treg për të penguar forcimin e mëtejshëm të monedhës vendase.

² Reflekton ndryshimet në metodologjinë e llogaritjes së kostos së transportit të mallrave, bazuar në vrojtimin statistikor të tregtisë së jashtme të kryer nga Banka e Shqipërisë.

Stoku i rezervave prej 908.5 milionë dollarësh ishte i mjaftueshëm për të mbuluar 5.3 muaj importe (mallrash dhe shërbimesh).

**Bilanci i Pagesave
në milionë dollarë amerikanë**

	3m-I 2002	3m-I 2003
Llogaria Korente	-28.9	-56.0
	0.0	0.0
Eksporti i mallrave	76.0	108.6
Importi i mallrave	-315.8	-394.1
Bilanci tregtar	-239.8	-285.5
Shërbimet: Kredi	104.4	127.5
Shërbimet: Debi	-103.8	-118.5
Të ardhurat: Kredi	32.6	36.6
Të ardhurat: Debi	-2.7	-4.4
Transferta private pa shpërblim	169.7	180.2
Transferta shtetërore pa shpërblim	10.7	8.1
Llogaria kapitale	16.8	31.0
Llogaria financiare	68.1	39.7
Investime direkte	22.0	27.0
Investime portofoli	-16.6	-11.1
Kapitale të tjera*	62.6	18.3
Gabime dhe Harresa Neto	-48.7	42.3
Bilanci i Përgjithshëm	7.3	57.0
Rezervat dhe zëra të lidhur me to.		
Mjetet e rezervës	-7.3	-57.0
Përdorim huash e kredish nga FMN	0.0	5.5
Për t'u mbajtur në vëmendje		
Ndryshimi total në Rezerva	-0.9	-61.0
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	-5.1	12.5

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

**Bilanci i Pagesave
në milionë euro**

	3m-I 2002	3m-I 2003
Llogaria Korente	-32.9	-52.2
Eksporti i mallrave	66.6	101.1
Importi i mallrave	-276.7	-367.0
Bilanci tregtar	-210.1	-265.9
Shërbimet: Kredi	91.5	118.8
Shërbimet: Debi	-90.9	-110.3
Të ardhurat: Kredi	28.6	34.1
Të ardhurat: Debi	-2.4	-4.1
Transferta private pa shpërblim	148.7	167.8
Transferta shtetërore pa shpërblim	9.4	7.5
Llogaria Kapitale	14.7	28.9
Llogaria Financiare	59.6	37.0
Investime direkte	19.3	25.1
Investime portofoli	-14.5	-10.3
Kapitale të tjera*	54.9	17.0
Gabime dhe Harresa Neto	-42.7	39.4
Bilanci i Përgjithshëm	6.4	53.1
Rezervat dhe zëra të Lidhur me to.		
Mjetet e rezervës	-6.4	-53.1
Përdorim huash e hredish nga FMN	0.0	5.1
Për t'u mbajtur në vëmendje		
Ndryshimi total në rezerva	-0.8	-56.8
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	-4.5	11.7

***/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN**

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave